



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and
industry

REPUBLIKA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE	
Nr. i Regjistrimit Reg. No.	03/PEN5
Nr. i Proje Proj. No.	1723
Nr. i Fletëve Proj. Stranica No. pages	2
Data Datum	11.11.16

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Ligji Nr. 03/ L -149, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë bën :

RISHPALLJE E KONKURSIT

Institucioni:

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve

Titulli i vendit të punës:

Zyrtar për promovimin e turizmit

Koeficienti / 7

Nr. i Referencës: MTI/28

Vendi: Prishtinë

Datë: 11.11.2016

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton dhe implementon strategjinë, politikat, procedurat, buxhetin, planin e punës të Sektorit dhe Drejtoratit konform treguesve kyç të performancës së përcaktuar për pozitën e tij.
- Nxitë dhe inkurajon interesimin për turizëm përmes promovimit proaktiv të turizmit duke përdorur aktivitet si marketingun direkt, telemarketingun, vizitat dhe prezantimet tek palët e interesuara ekzistuese dhe potenciale, vizitat dhe prezantimet në takimet B2B, G2G, G2B dhe aktivitetet tjera të përpiluara vet apo nga Udhëheqësi i Sektorit.
- Mbështet palët e interesuara ekzistuese dhe potenciale para, gjatë dhe pas aktivitetet promovuese të turizmit duke përfshirë, por pa u kufizuar në: përgatitjen e vizitave hulumtuese, shërbime të përkujdesjes së mëtejshme (aftercare), asistimin në përmbushjen e procedurave administrative në mënyrë ekspeditive, sigurimin e të gjithë informacionit të nevojshëm, aranzhimin e takimeve me palët e sektorit të turizmit, etj.
- Implementon mbledhjen, ruajtjen, përpunimin dhe analizimin e thukës të të dhënave dhe informacioneve të gjeneruara gjatë punës së tij dhe sugjeron që ato të përdoren në përpilimin e materialeve të ndryshme të promovimit të turizmit duke përfshirë, por pa u kufizuar në: prezantime, broshura, video klipe, fletëpalosje, faqe interneti, buletine, etj.
- Ndërton dhe vazhdimisht përmirëson marrëdhënie me sektorin e turizmit, institucionet qeveritare e OJQ-të, ambasadat, shoqatat e biznesit e odat ekonomike, agjencitë multilaterale, etj. - qofshin të sipërpërmendurat kombëtarë e ndërkombëtarë, ekzistuese apo potenciale, brenda apo jashtë Kosovës - duke ndërtuar dhe mirëmbajtur mekanizma të mirëfilltë komunikimi e informimi.
- Harton dhe përditëson të dhënat mbi potencialin turistik të vendit, me qëllim promovimin e tij.
- Përmes analizës së tregut identifikon regjionet gjeografike dhe ndërmarrjet që kanë potencial, kapacitet dhe mundësi të ngrisin nivelin e turizmit brenda vendit dhe përpilon, në koordinim dhe

aprovim të Udhëheqësit të Sektorit, aktivitetet e tij, materialet promovuese dhe pjesëmarrjen e tij dhe përfaqësuesve të ndërmarrjeve në konferenca dhe panairë kombëtare e ndërkombëtare konform rezultateve të këtyre analizave.

- Kryen detyra të tjera sipas nevojës për të realizuar misionin, qëllimet, objektivat, aktivitetet dhe detyrat e Sektorit, të Drejtoratit dhe të Agjencisë dhe/ose sipas kërkesave të Udhëheqësit të Sektorit.

Kualifikimet për këtë vend të punës:

- Diplomë universitare në Ekonomi, Menaxhment, Marketing apo Financa/Banka;
- Së paku dy (2) vite përvojë pune, me preferencë në shitje dhe/ose marketing;
- Njohuri dhe përvojë substanciale në identifikimin dhe promovimin e potencialeve investuese, eksportuese dhe turistike;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion;
- Njohuri të shkëlqyeshme (në të folur dhe në të shkruar) të gjuhës shqipe dhe angleze;
- Njohja e më shumë gjuhëve të huaja e preferuar;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet);

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e lartë dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Kohëzgjatja e emërimit:

Nëpunësi i karrierës (përhershëm) Periudha provuese .Dymbëdhjetë (12) muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

25.11.2016

Paraqitja e kërkesave

Formularët për aplikim mund të merren në recepcion të MTI-së, ose të tërhiqen nga web faqja e MTI-së, ku është bërë edhe shpallja e konkursit , në adresën **www.mti-ks.org** dhe dorëzohen në Divizionin e Burimeve Njerëzore, çdo ditë pune nga ora 8:00 -16:00 deri më: **25.11.2016**. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr. tel. 038-200 36-578.

“Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë”.

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcionalë organet e shërbimit civil të administratës publike,qendrore dhe lokale,siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3të Ligjit Nr..03/L-149 mbi shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen.

Për shkak te numrit të madh të kërkesave të pranuara,vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.